

VENDIM
Nr. 603, datë 29.7.2020

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË
TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, dhe 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (Lista e OKB-së), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar, të bëhet shtesa, si më poshtë vijon:

Në listën e shkronjës “C”, të titulluar “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da’esh) dhe AL-Qaida”, shtohet individi i renditur në shkronjën “a”, sipas shtesës bashkëlidhur këtij vendimi, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për persona që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues të organizatave ISIL (Da’esh) dhe AL-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

PËRDITËSIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË
TERRORIZMIT, SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT TË OKB-
SË (LISTA E OKB-së)

C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATAT ISIL (DA’ESH) DHE AL-QAIDA”:

a) Lista e shtuar në “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da’esh) dhe AL-Qaida”:

Noor Wali Mehsud

Shënim. Gjenealitetet e tjera për personin, emri i të cilit është renditur më sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.